

**STATUT**  
**I**  
**SHOQËRISË TREGTARE**  
**"K.A.E.XH." SHPK**  
**(Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar)**



**KREU I I**  
**Forma, emërtimi, selia**

**Neni 1**

Shoqëria tregtare "K.A.E.XH." SHPK formohet si shoqëri tregtare nga ortakut themelues: z. Kapllan CUKU, i biri i Bajramit, i dt.lindjes 02.05.1964, shtetas shqiptar, mbajtës i pasaportës me Nr. 0891177, banues në Selitë e Vogël pranë kopështit Zoologjik - Tiranë, i cili me vullnetin e tij të lire dhe në përputhje me ligjin Nr. 7638 dt. 19.11.1992 "Për Shoqërite Tregtare", nëpërmjet Aktit të Themelimit ka vendosur të destinohet në një sipërmarrje pasuri të tij me qëllim që të ndajë fitimin ose që të mund të përfitojë nga të ardhurat që rrjedhin prej saj.

**Neni 2**

Shoqëria është e organizuar si shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar dhe do të mbaje emërtimin: "K.A.E.XH." SHPK  
Në rast transferimi të veprimtarisë mund të ruhet i njëjti emërtim me kusht që personi juridik të shtojë në këtë emërtim një shenim i cili ka të bëjë me transferimin.

**Neni 3**

Shoqëria tregtare "K.A.E.XH." SHPK është person juridik shqiptar me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë në Selitë të Vogël, pranë kopështit Zoologjik - Tiranë  
Shoqëria do të ketë vulën e saj.

**Neni 4**

Shoqëria mund të marrë pjesë në krijimin e një filiali të saj, mund të jete pjesëmarrëse në një shoqëri tregtare apo mund të kontrollojë shoqëri të tjera tregtare si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.  
Njësitë strukturore të shoqërisë në format e mesiperme do të krijohen në përputhje me legjislacionin shqiptar kur ndodhen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj në përputhje me legjislacionin e vendit ku Personi Juridik ka qendren e tij.

**Neni 5**

Shoqëria tregtare "K.A.E.XH." SHPK fiton personalitet juridik nga dita e regjistrimit të saj në Gjykatën e Shkallës Parë Tiranë në Regjistrin Tregtar pranë kësaj Gjykate.  
Ndryshimet e shoqërisë duke përfshirë edhe përcaktime të mëvonshme në lidhje me kohëzgjatjen e aktivitetit të saj nuk sjellin si pasojë krijimin e një personaliteti juridik të ri.

**Neni 6**

Shoqëria tregtare "K.A.E.XH." SHPK ka si objekt të veprimtarisë së saj:  
Import - Eksport, prodhim, transport, tregëtim të materialeve të ndryshme për ndërtime si dhe shërbime të lidhura me aktivitetin e ndërtimit të objekteve të karakterit publik e privat, industrial, bujqësor, tregtar, ushqimor, të shërbimeve etj.  
Import - Eksport, prodhim, transport, tregëtim i artikujve të ndryshëm industrialë, paisjeve elektro-shtëpijake, elektronike, materialeve e lëndëve të para, i artikujve ushqimorë, etj.  
Hapje dhe shfrytëzim hotelesh, baresh, restorantesh, diskoteka, qendra pushimi e kurative.  
Projektimi e ndërtimi i objekteve turistike, shtëpive të banimit, hoteleve, veprave social-kulturore, infrastrukture etj. prej murature e skelet b/arme, instalime hidrosanitare, furnizimi

## SHOQËRIA TREGTARE "K.A.E.XH." SHPK \_ TIRANË

me ujë-kolektor shkarkimi, ujesjelles kanalizime urbane-rurale, vepra ujtje-kullimi-impianje vaditese-diga-damba, vepra te trajtimit te ujit, rruge, shtresa rrugore e sistemim-asfaltime.

Punime dheu, sistemime, terracime terenesh, ndertime civile- ekonomike, ushtarake, turistike, bujqesore, ndertime banese me skelet mbi 8 kate, ndertim rruge kat. I, II, III, IV dhe V, ndertim punime te mirembajtjes dhe sinjalizimit ne rruge, ndertim mbi shtresa rrugore, veshje me asfaltobeton të rrugëve si dhe sistemim e asfaltim sheshe, punime hekurudhore, punime speciale te shinave dhe traversave, punime ne sistemin elektrik dhe te sinjalizimit, ndertim vepra arti rrugore e hekurudhore-estakada-ura metalike-te varura, ndertim tunele rrugore e hekurudhore, ndertime portuale-bankina-basene-pontile, punime thellimi-drenimi, ndertim ujesjelles-kanalizime-kanale e impianje vaditese, ndertim vajsjelles-gazsjelles-naftesjelles, ndertim diga-damba, ndertim galeri-tunele, ndertim diga te larta, sillose, kulla, kulla uji etj., b/arme-metalike, perforcime themelie, punime nentokesore, izolime mbi dhe nentokesore nga ujrat, instalimi i impianjeve higjenike, kuzhina, lavanteri, hidrosanitare-mirembajtja e tyre, punime bojatisje-hidroizolimi-termoizolimi-akustike-kundra zjarrit,

Prodhim materiale inerte-gure, prodhim elemente betoni e b/arme te zakonshme-pararendur-gure dekorative, punime të ndryshme druri e duralumini, tregëtimi i tyre.

Import - Eksport, prodhim e transport per te tretet me materialin e vet ose te porositesit. (Fason)

### Neni 7

Për plotësimin e objektit të saj shoqëria mund të realizojë lidhjen e kontratave, marrëveshjeve, ortakërive, shoqërive të përbashkëta apo forma të tjera të lejuara nga legjislacioni shqiptar, me persona fizikë dhe juridikë publik apo privat, shqiptarë ose të huaj, për të realizuar veprimtari të ndryshme që janë të nevojshme dhe me interes për Shoqërinë.

### Neni 8

Shoqëria "K.A.E.XH." SHPK do të përmbushë objektin e veprimtarisë së vet për një afat kohe të pakufizuar (të pacaktuar)

### Neni 9

Shoqëria tregtare "K.A.E.XH." SHPK nuk përgjigjet për detyrimet që rrjedhin nga veprimtaria ekonomike-tregtare apo industriale që ortaku zhvillon në mënyrë të pavarur prej saj.

## KREU I II

### Neni 10

#### Kapitali

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 lek (njëqindmijë lek). Ky kapital përbëhet nga kontribute në para.

Pjesëmarrja në kapitalin themeltar të shoqërisë tregtare "K.A.E.XH." SHPK është:

z. Kapllan Cuku 100.000 lek ose 100 % të kapitalit themeltar.

Në bazë të kontributit të lartpërmendur: z. Kapllan Cuku, zotëron 100 (njëqind) pjesë të kapitalit themeltar të renditura nga numri i serisë 1 (një) deri në numrin e serisë 100 (njëqind); Pjesët e kapitalit themeltar të shoqërisë janë tërësisht të nënshkruara dhe të shlyera nga ortaku.

### Neni 11

Kapitali themeltar i Shoqërisë është i ndarë në 100 (një qind) pjesë me vlerë nominale 1.000 (njëmijë) lekë secila, të renditura sipas numrit të serisë nga 1 (një) deri në 100 (njëqind).

Në bazë të kontributit të lartpërmendur: z. Kapllan Cuku, zotëron 100 (njëqind) pjesë të kapitalit themeltar të renditura nga numri i serisë 1 (një) deri në numrin e serisë 100 (njëqind);

Pjesët e kapitalit themeltar të shoqërisë janë tërësisht të nënshkruara dhe të shlyera nga ortaku.

### Neni 12

Kapitali baze i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "K.A.E.XH." SHPK sipas nenit 10 të këtij akti përfaqëson kapitalin e duhur për themelimin e shoqërisë tregtare.

Kapitali i nevojshëm për veprimtari ekonomike e tregtare të shoqërisë do të trajtohet si kapital investues.

## SHOQËRIA TREGTARE "K.A.E.XH." SHPK \_ TIRANË

### Neni 13

Në bazë të kapitalit themeltar të shoqërise tregtare fitimi do të ndahet në menyre të përcaktuar nga Ligja dhe në Nenet 7 e 15 të Aktit të Themelimit.

### Neni 14

Shoqëria krijon fondin rezerve dhe fondet e tjera të vecanta të financimit për zhvillimin ekonomik, tregtar, për krijimin e vlerës etj.

### Neni 15

Shoqëria tregtare "K.A.E.XH." SHPK është pronare e pasurisë së saj, të cilën e përdor dhe e disponon atë në emër të saj në përputhje me qëllim dhe objektin e veprimtarisë së shoqërise.

Shoqëria është e lirë të blejë dhe të shfrytëzojë të drejta të tjera materiale në përputhje me legjislacionin përkatës shqiptar.

Të gjitha shpenzimet për ushtrimin e aktivitetit tregtar, asistencë teknike e juridike paguhen nga fondet e shoqërise.

Pasuritë e shoqërise vlerësohen në Monedhe shqiptare.

### Neni 16

Perberja e kapitalit të shoqërise, fondet e krijimit të saj si dhe përdorimi i rregullimi i çdo fondi të veçantë përcaktohen nga Organi drejtues sipas të drejtave dhe detyrave të përcaktuara në ligj e në statut.

Të ardhurat e përgjithshme të shoqërise dhe në përgjithësi çdo operacion financiar i saj do të pasqyrohet në Kontabilitetin e Shoqërise sipas ligjeve në fuqi dhe në mbështetje të akteve përkatëse të rrjedhura prej saj.

Të ardhurat neto që do të rezultojnë nga bilanci i miratuar nga Ortaku i vetëm do të kalojnë për atij sipas neneve 7 e 15 të Aktit për themelimin e shoqërise.

### Neni 17

Aktiviteti financiar i shoqërise do të mbyllet më 31 Dhjetor të çdo viti dhe Bilanci do të miratohet brenda tre muajve të vitit në vazhdim.

### Neni 18

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirish të transferueshme në rrugë trashëgimie. Ato janë lirish të transferueshme edhe në rast ndarje pasurore midis bashkëshorteve si dhe ndërmjet pasardhësve dhe paraardhësve.

### Neni 19

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar me trashëgimi ose brenda familjes personave përfitues do të bëhet pasi ata të pranojnë përmbajtjen e statutit të kësaj shoqërie megjithë ndryshimet që ai mund të ketë pësuar deri në momentin që këto pjesë të kapitalit themeltar bëhen të transferueshme.

Në rast mos pranimit pjesët e kapitalit themeltar mund të transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri vetëm me miratimin e shumicës që përfaqësojnë të paktën  $\frac{3}{4}$  e pjesëve të kapitalit themeltar ose shihet mundësia e blerjes së tyre nga shoqëria.

### Neni 20

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirish të transferueshme ndërmjet ortakeve të mundshme të ardhshme të kësaj shoqërie tregtare.

### Neni 21

Zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit themeltar me anë të kontributeve me para dhe në natyrë bëhet me miratimin e ortakut të vetëm mbi bazën e një projekti të paraqitur nga eksperti kontabel i autorizuar dhe me kërkesën e ortakut themelues.



# SHOQËRIA TREGTARE "K.A.E.XH." SHPK \_ TIRANË

## KREU i III

### Neni 22

Ortakeria per shoqerine tregtare "K.A.E.XH." SHPK krijohet dhe mbeshtet ne Aktin e Themelimit, ne Statutin e kesaj shoqerie dhe ne Ligj.

### Neni 23

Ortaku i vetëm shoqerise tregtare "K.A.E.XH." SHPK gëzon te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe pasqyrohen ne legjislacionin e Republikes se Shqiperise.

### Neni 24

Ortaku merr persiper, per plotesimin e sukseshem te objektit te kesaj shoqerie tregtare, te vere ne dispozicion aftesite e tij tekniko-organizative, sigurimin e te gjitha lendeve te para te domosdoshme me çmimet e tregut si dhe te ndjeke vijueshmerine e shoqerise personalisht apo edhe nepermjet nje perfaqesuesi ligjor sipas rregullave te ketij Statuti.

## KREU i IV

### Organizimi i shoqerise tregtare

### Neni 25

Shoqëria tregtare "K.A.E.XH." SHPK ka si struktura drejtuese:

Ortakun e Vetëm

Administratorin.

Ajo me vendim të Ortakut të vetëm mund të krijojë organe administrative të karakterit teknik. Shoqeria tregtare me miratim te ortakut te vetem vendos dhe emërtime honorifike.

### Neni 26

Kompetencat e Ortakut të Vetëm :

Vendos për politikën afariste të shoqërisë dhe përcakton fushat konkrete të veprimtarisë së saj

Miraton bilancin vjetor te shoqerise

Miraton ndryshimet ne statut

Vendos për zmadhimin apo zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise

Emëron dhe shkarkon administratorin e shoqerise tregtare,

Shpall prishjen, likuidimin dhe falimentimin e shoqerise tregtare,

Shprehet per kohezgjatjen e shoqerise tregtare,

Miraton marreveshjet e arritura ne qarkullimin civil te saj,

Miraton strukturat e shoqerise etj.

Çdo vendim tjeter qe i njihet nga ligji, Akti i Themelimit dhe Statuti i shoqerise.

Vendimet e marra shënohen dhe firmosen në regjistrin e shoqërisë nga ortaku i vetëm.

### Neni 27

Ortaku ne kete shoqeri tregtare nuk mund te ngarkoje nje mandatmbajtes te votoje ne emer te nje pjese te kapitalit te tij themeltar duke votuar ai vete ne emer te pjeses tjeter te kapitalit te tij themeltar.

### Neni 28

Administrimi i shoqerise tregtare "K.A.E.XH." SHPK kryhet nga personi fizik i zgjedhur ne cdo rast nga ortaku themelues i shoqerise tregtare.

Ai emerohet me vendim te ortakut te vetem.

Administrator i shoqerise tregtare "K.A.E.XH." SHPK eshte emëruar **z. Kapllan Bajram Cuku**

### Neni 29

Kompetencat e administratorit/rëve janë :

të mbikqyre dhe kontrolloje gjithë veprimtarine e shoqerise.

1  


## SHOQËRIA TREGTARE "K.A.E.XH." SHPK \_ TIRANË

të vendose për çdo problem që i lind shoqërisë në aktivitetin normal të përditshëm.  
të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhëniet e saj me të tretët, në administratën publike e në organet gjyqësore  
të emeroj prane shoqërisë personelin e domosdoshëm që i nevojitet asaj në përmbushjen e aktivitetit tregtar e ekonomik.  
të paraqesë për miratim Ortakut të Vetëm strukturën e brendshme organizative të shoqërisë me emra perkates dhe të përmbushë gjithë detyrimet ligjore që rrjedhin nga Kodi i Punes i Republikës së Shqipërisë.  
të testojë aftësinë e punonjësve në administratë.  
të propozojë Ortakut të Vetëm çështjet që duhen analizuar si dhe të përgatisë dokumentacionin dhe raportet e ndryshme për gjëndjen ekonomik-financiare të shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi  
të hartojë objektivat e shoqërisë për çdo vit pasues dhe të vendosë e të ndjeke realizimin e detyrave të lëna nga Ortaku i vetëm, etj.  
Si dhe çdo detyrë të njohur e të përcaktuar në ligj

### Neni 30

Administratori është përgjegjës individualisht sipas rastit ndaj vetë shoqërisë ose ndaj të tretëve për shkelje të legjislacionit, për shkelje të statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

### Neni 31

Drejtuesi teknik përgjigjet për të gjithë veprimtarinë teknike e profesionale, që do të zhvillojë kjo shoqëri konform legjislacionit.

### Neni 32

Shoqëria tregtare "K.A.E.XH." SHPK emeron eksperte kontabel të autorizuar. Emerimi kryhet nga Ortaku i vetëm  
Për kompetencat, detyrimet, përgjegjësitë, zëvendeshueshmërinë, tërheqjen, shkarkimin dhe shpërblimin e ekspertit kontabel të autorizuar zbatohet legjislacioni shqiptar në fuqi.

### Neni 33

Të gjithë personat që do të punesohen prane kësaj shoqërie tregtare, punesimi i tyre do të bëhet mbi bazë kontrate në të cilën do të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet ligjore të secilës pale si dhe paga mujore në mbështetje të legjislacionit shqiptar në këtë fushë.

## KREU i V

### Bashkimi dhe ndarja e shoqërisë

### Neni 34

Shoqëria tregtare "K.A.E.XH." SHPK me anë të bashkimit mund t'i kalojë trashëgimë e saj një shoqërie ekzistuese ose një shoqërie të re që ato themelojnë.  
Gjithashtu me anë të ndarjes ajo mund t'i kalojë trashëgimë e saj disa shoqërive të tjera ekzistuese ose disa shoqërive të reja.

### Neni 35

Në rast se operacioni përfshin krijimin e shoqërive të reja secila prej tyre themelohet sipas rregullave që i perkasin formës së shoqërisë që do të krijohet.

## KREU i VI

### Prishja dhe Likuidimi i shoqërisë

### Neni 36

Shoqëria tregtare "K.A.E.XH." SHPK prishet kur:



## SHOQËRIA TREGTARE "K.A.E.XH." SHPK \_ TIRANË

1. Ortaku themelues nuk respekton te drejtat e detyrimet e percaktuara ne Aktin e Themelimit dhe ne kete Statut.
2. Veprimtaria e ortakut te shoqerise perben shkelje te renda te aktit te themelimit dhe te statutit.
3. Kur ortaku themelues refuzon marrjen e vendimeve të domosdoshme për ecurinë e shoqërisë në përputhje me objektin e saj dhe rregullat e percaktuara në Statut e në ligj mbas dy lajmerimeve radhazi dhe çmohet pamundesia e permbushjes se objektit te shoqerise
4. Shoqeria nuk priset kur vdes ortaku
5. Shoqeria nuk priset kur falimenton ose shfaq paaftesi ortaku
6. shoqeria priset me vendim te Gjykates

### Neni 37

Likujdimi i shoqerise tregtare "K.A.E.XH." SHPK vendoset nga Ortaku i Vetëm kur:

1. plotesohet qellimi per te cilin eshte krijuar kjo shoqeri tregtare
2. kur priset shoqeria
3. me vendim të Gjykatës

### Neni 38

Ne kete rast nga ana e ortakut te vetem caktohet nje likujdues te cilit i ngarkohet ne menyre te specifikuar detyra per menyren e likujdimit.

Ne rastin e parashikuar ne nenin 36 pika 3 likujdimi vendoset nga Gjykata me kerkesen e Administratorit ose çdo personi të interesuar. Kerkesa duhet te permbaje dokumentacionin e parashikuar ne kete statut dhe ne Ligjin per Shoqerite tregtare.

### Neni 39

Transferimi i plote i aktivitet te shoqerise apo kontributi ne aktiv te nje shoqerie tjeter, vecanerisht me ane te procesit te bashkimit duhet te autorizohet me pelqimin e ortakut themelues.

### Neni 40

Ortaku themelues thirret ne fund te procesit te likujdimit qe te vendose per bilancin financiar perfundimtar.

### Neni 41

Ne qofte se per mbylljen e parashikuar ne nenin 40 ortaku i vetem nuk mund te marre vendim ose ne qofte se nuk pranon te miratoje llogarite e likujduesit vendimi merret nga Gjykata me kerkesen e likujduesit ose te cdo personi te interesuar.

## KREU i VII

### Neni 42

Mosmarveshjet e mundshme zgjidhen me mirekuptim nga ana e ortakut dhe strukturave te tjera te shoqerise apo me të tretët.

Ne rastet kur mosmarveshjet nuk mund te zgjidhen me mirekuptim apo ne rruge administrative kompetente per zgjidhjen e tyre eshte Gjykata e Shkalles Pare Tiranë

### Neni 43

Ky statut perpilohet ne 4 (kater) ekzemplare origjinale, në gjuhën shqipe, me të njëjtat vlera ligjore dhe nënshkruhet nga ortaku i vetëm më datë. 20. 10. 2005

**Ortaku themelues**

**Kapllan Bajram CUKU**

